



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.79/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “RSM Company” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-40420-10-22-2019, me *objekt “Rikonstruksion i Ures së Vorës”*, me fond limit 18.794.948,46 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** “RSM Company” shpk
Kosovë Cakllavicë, Prishtinë dhe Adresa e degës në Shqipëri Tiranë Njësia nr.8, Rruga Xhorxhi Martini, Nr.20, Godinë 11 katëshe, shkalla 2, Kati 7.
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri”, nr.33, Tiranë
- Subjekt i Interesuar:** “Leon Konstruksion”
Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.10.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-40420-10-22-2019, me objekt “Rikonstrukcion

i Ures së Vorës”, me fond limit 18.794.948,46 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 25.11.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 22.12.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Besa 3-2006	10,228,371	I skualifikuar
- Inerti	12,364,802.07	I skualifikuar
- Company Riviera 2008	12,522,131	I skualifikuar
- SMO Union	12,857,286	I skualifikuar
- RSM Company	13,023,582.76	I skualifikuar
- K-AAV	13,261,342	I skualifikuar
- Leon Konstruksion	13,721,052.16	I kualifikuar
- B-93	14,666,163	I kualifikuar
- INA	14,974,444	I skualifikuar
- Vëllezrit Hysa	15,938,097	I kualifikuar
- Pepa Group	15,967,583.14	I kualifikuar
- Nika	16,133,854	I skualifikuar
- Al-Asfalt	16,166,324	I kualifikuar
- BE-IS	16,744,223	I kualifikuar
- 2T	17,251,089.93	I kualifikuar
- Agi Kons	17,582,010	I skualifikuar
- Sireta 2F	17,777,777	I kualifikuar
- Star Tek	18,182,888.6	I kualifikuar

II.4. Në datën 22.12.2019 operatori ekonomik “RSM Company” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Sipas shtojcës nr.10 “Mbi disponimin e makinerive” operatori ka deklaruar se ka në pronësi një fadromë. Sipas dokumentave të ngarkuara në sistem fadroma rezulton e zhdoganuar ne vitin 2019 në Republikën e Shqipërisë (deklarata e zhdoganimit) por nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm të lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi, Çertifikatë pronësie, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit) dukë dështuar të plotësojë kriterin 2.3.10 sipas DST.

2. Sipas shtojcës 10 operatori ekonomik ka deklaruar se ka marrë me qera një fadromë nga subjekti “Caushi M” për të cilën subjekti qiradhënës disponon kontratën e shit-blerjes me një person të tretë, por në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të gjithë

dokumentat (Çertifikata e pronësisë, leje qarkullimi, akt kontrolli teknik, policë sigurimi) janë në emër të personit të tretë pavarësisht se është kryer shitja. Dokumentat datojnë pas aktit të shit-blerjes së subjektit “Caushi – M” me personin e tretë. Operatori nuk plotëson kriterin 2.3.10 sipas DST.

3. Sipas shtojcës 10 operatori ekonomik ka deklaruar se ka marrë me qera “Makinerinë pastrim me rërë kuarci me presion për heqjen e ndryshkut”. Në kontratën e qirasë midis operatorit dhe subjektit “ESSA Industry” nuk është cituar afati i kontratës në kundërshtim me kriterin 2.3.10 ...për pajisjet teknike me qira, kontrata e qirasë duhet, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizmit të kontratës... duke mos garantuar mbulimin me makineri për të gjithë periudhën e ekzekutimit të punimeve.

4. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1/a (Për kapacitetin teknik – punët e ngjashme) pasi në dokumentacion e ngarkuar në sistem operatori dështon të tregojë që të ketë kryer punime riparimi ose rikonstruksioni, punime hekuri e betoni (sasitë e ekzekutuara në kontratat e ngjashme janë të papërfillshme) si dhe mungesë punimesh në vepra arti të vogla e mëdha.

II.5. Në datën 27.12.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit ju sqarojmë se: për të përmbushur kriterin sipas pikës 2.3.10 tek kriteret e vecanta të kualifikimit kemi paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të AK dhe e kemi pasqyruar në shtojcën nr.10 Mbi disponimin e makinerive.*

Fadroma në pronësi të shoqërisë RSM Company shpk me numër shasië ËB98AF20217 me Faturë Nr.R 2379 dt 09.02.2015 të cilën e kemi deklaruar tek shtojca nr.10 mbi disponimin e makinierive nuk është e cdoganuar në RSH sic pretendon AK por është me regjim doganor të përkohëshëm. Për të plotësuar kriteret sipas pikës 2.3.10 përvec faturës Nr.R 2379 dt 09.02.2015 që vërteton pronësisë e Fadromës, Administratori i shoqërisë RSM Company më datë 25.11.2019 shpk ka paraqitur një deklaratë me shkrimme anë të së cilës deklarohet se: Në Republikën e Kosovës për Fadromat me Goma nuk lëshohet:

- 1. Certifikatë e pronësisë*
- 2. Leje qarkullimi*
- 3. Certifikatë e kontrollit teknik*
- 4. Siguracion i mjetit*

Nisur nga fakti se në Republikën e Kosovës për Fadromat me goma nuk lëshohen certifikatë e pronësisë, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracion i mjetit, për të përmbushur kriterin e pikës 2.3.10 të DT kemi paraqitur përvec Faturës Nr.R 2379 Dt 09.02.2015 që vërteton pronësisë e Fadromës edhe deklartën me përmbajtjen e mësipërme+foto të fadromës pra është e qartë se RSM Company shpk e ka përmbushur kriterin 2.3.10 të DT.

Për sa më sipër arsyeja e skualifikimit e dhënë nga AK nuk qëndron dhe është në kundërshtim të plotë të ligjit Për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014.

- *Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit ju sqarojmë se: Nga shoqëria RSM Company shpk pranë zyrës noteriale më datën 18.11.2019 është lidhur kontrata e qerasë mr nr.1975 rep nr.342/1 kol me shoqërinë Caushi M shpk për disa makineri ndër të cilat edhe për një Fadromë me targa AGMT18 dhe me nr shasie CAT0442DKBRG00952, pronësia e të cilës vërtetohet me kontratë shitblerje automjeti noteriale me nr. 2474 rep nr.1161 kol e datës 14.12.2018 dhe për transferta bankare (fatura), dt 14.12.2018 me të cilën është bërë pagesa në favor të personit shitës. Fadroma me targë AGMT18 dhe me nr.shasie CAT0442DKBRG00952, për të cilën kemi lidhur kontratë qeraje është me të gjithë dokumentacionin e plotë ligjor (certifikata e pronësisë, leje qarkullimi, akt kontrolli teknik, policë sigurimi, foto) sic kërkohej nga AK në pikën 2.3.10 tek kriteret e vecanta të kualifikimit, dhe e kemi pasqyruar në shtojcën nr.10 mbi disponimin e makinerive. Nga AK sipas pikës 2.3.10 Kriteret e vecanta të kualifikimit në DT kërkohej vetëm një Fadromë. RSM Company për të plotësuar këtë kriter ka paraqitur dy fadroma , Fadromën me Nr.R 2379 dt 09.02.2015 të cilën e kemi në pronësi dhe Fadromën që kemi marrë me qerra tek shoqëria Caushi M shpk të përshkruara më lart. Është e qartë që RSM Company shpk i ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas pikës 2.3.10 tek kriteret e vecanta të kualifikimit në DT për Fadromën dhe për të gjitha makineritë e tjera sipas kërkesave të AK. Për sa më sipër edhe arsyeja e dytë skualifikimit e dhënë nga AK nuk qëndron dhe është në kundërshtim të plotë të LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.*
- *Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit ju sqarojmë se: Për të plotësuar kriterin për Makineri pastrimi me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku shoqëria RSM Company shpk më datë 22.11.2019 ka lidhur kontratën e qerasë mr Nr.2005 Rep Nr.356/1 Kol me shoqërinë ESSA Industry” shpk për një periudhë deri në përfundim të punëve në objektin “Rikonstrukcion i Urës së Vorës” dhe në kontratë është deklaruar qartësisht nga qeradhënësi shoqëria Essa Industry shpk se Makineria për pastrim me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku nuk i është dhënë me qera ndonjë suubjekti tjetër për këtë periudhë. Shoqëria RSM Company shpk tek shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive ka*

deklaruar të gjitha makineritë dhe pajisjet që kërkoheshin nga ana e AK dhe ka përshkruar të gjitha makineritë dhe pajisjet që kërkoheshin nga ana e AK dhe ka përshkruar të gjitha të dhënat sic kërkohen në formularin standart shtojca 10 mbi disponimin e makinerive dhe po të shikohet me vëmendje nga ana e AK shtojca mbi disponimin e makinerive tek makineritë me qera pika 14 Makinaria për pastrim me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku” është me nr.2005 Rep Nr. 356/1 kol dhe afati i kontratës është : dt 22.11.2019-deri në përfundim të punimeve në objekt. Pra është e qartë se kontrata e qerasë për Makinaria për pastrim me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku e përfshin gjithë periudhën që nevojitet për realizimin e kontratës duke garantuar mbulimin me makineri për të gjithë periudhën e ekzekutimit të punimeve dhe në kontratë është deklaruar qartësisht nga qeradhënësi shoqëria Essa Industry shpk se se Makinaria për pastrim me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku nuk i është dhënë me qera ndonjë suubjekti tjetër për këtë periudhë.

- Në lidhje me arsyen e katërt të skualifikimit ju sqarojmë se: për plotësimin e kriterit pikës 2.3.1 për kapacitetin teknik tek kriteret e vecanta të kualifikimit shoqëria RSM Company shpk ka paraqitur dhe ngarkuar në sistemin e APP tre punë të ngjashme si më poshtë:

1. Kontratën e ngjashme me objekt “Asfaltim i rrugës Shefqet Kuka” me vlerë 61,727,335.92 lekë me tvsh sipas situacionit përfundimtar të punimeve.
2. Kontratën e ngjashme me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të lagjeve Maknor-Kolje-Ledhe” me vlerë 60,974,089.77 lekë me tvsh sipas situacionit përfundimtar të punimeve.
3. Kontratën e ngjashme me objekt Sinjalistikë vertikale dhe horizontale me vlerë 19,949,139.82 lekë me tvsh sipas situacionit përfundimtar të punimeve.

Në lidhje me tre punët e ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik RSM Company zërat e punimeve sipas situacioneve përfundimtare të punimeve të kryera janë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit të prokurimit publikuar në faqen e internetit të APP nga ana e autoritetit kontraktor ARSH oër këtë projekt.

Në situacionet përfundimtare të paraqitura nga shoqëria RSM Company shpk në lidhje me punën e ngjashme janë zërat e ngjashëm të punimeve që ka edhe preventivi i objektit të prokurimit dhe nuk është e vërtetë se shoqëria RSM Company shpk nuk ka kryer punime riparimi ose rikonstruksioni, punime hekuri e betoni, punime vepra arti etj. Vlera e fondit limit për objektin Rikonstruksion i Urës së Vorës është 18,794,948.46 lekë pa tvsh. Vlera totale e punëve të ngjashme të paraqitura nga shoqëria RSM Company shpk në total për këtë projekt është 142,650,563 lekë pa tvsh dhe nuk mund të konsiderohen të papërfillshme sasitë e ekzekutuara në kontratat e ngjashme.

Operatori ekonomik RSM Company shpk me punët e ngjashme të paraqitura dhe të ngarkuara në sistem vërteton përmbushjen e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik deri tek kriteret e vecanta të kualifikimit.

Sa më sipër arsyet e skualifikimit të shoqërisë RSM Company shpk janë të pabazuara në ligj dhe prova dhe për rrjedhojë nuk qëndrojnë. Kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë .

II.6. Në datën 31.12.2019 me shkresën nr. 11778/2 prot operatori ekonomik ankimues “RSM Company” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 08.01.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.379/1 prot datë 15.01.2020 protokolluar me tonën me nr.18/2 prot datë 21.01.2020. me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “RSM Company” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Sipas shtojcës nr.10 “Mbi disponimin e makinerive” operatori ka deklaruar se ka në pronësi një fadromë. Sipas dokumentave të ngarkuara në sistem fadroma rezulton e zhdoganuar ne vitin 2019 në Republikën e Shqipërisë (deklarata e zhdoganimit) por nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm të lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi, Çertifikatë pronësie, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit) dukë dështuar të plotësojë kriterin 2.3.10 sipas DST”, si dhe Sipas shtojcës 10 operatori ekonomik ka deklaruar se ka marrë me qera një fadromë nga subjekti “Caushi M” për të cilën subjekti qiradhënës disponon kontratën e shit-blerjes me një person të tretë, por në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të gjithë dokumentat (Çertifikata e pronësisë, leje qarkullimi, akt kontrolli teknik, policë sigurimi) janë në emër të personit të tretë pavarësisht se është kryer shitja. Dokumentat datojnë pas aktit të shit-blerjes së subjektit “Caushi – M” me personin e tretë. Operatori nuk plotëson kriterin 2.3.10 sipas DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.10 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.10 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Fadroma	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion 25 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamionçine 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Makineri Frezimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Rul hekure-hekur me kapacitet 5-12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Nivelues me goma (Rul)	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Furçe teli (metalike)	në pronësi ose me qira	Copë 5
12	Makineri pastrimi me rere kuarci me presion (garned 0.2-0.6mm) per pastrim ndryshku	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Saldatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Trapan	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Skele metalike 9deri 10m)	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Makineri vijezimi	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga **DPSHTRR** (leje qarkullimi), certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/ çdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të përkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatëse.

- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes /kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerase, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor. Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerase, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerase duhet, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontrates dhe të deklarohet qartësisht nga qeradhënsi që mjete nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes "RSM Company" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 10 "Mbi disponimin e makinerive" ku rezulton ndër të tjera e deklaruar në cilësinë e fadromës në pronësi të tij, mjete me nr shasie EB98AF20217 me Faturë me Nr.R2379 dat 09.02.2015 dhe me qera Fadroma me targa AGMT18 me kontratë qeraje me Nr.1975Rep, Nr.342/1 Kol.
- Deklaratë e operatorit pjesmarrës në procedurën e prokurimit me objekt *Rikonstruksion i Urës së Vorës* me përmbajtje si vijon: Unë i nënshkruari A.K në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik "RSM Company" shpk deklaroj se: Në Republikën e Kosovës për Fadromat me goma nuk lëshohet:
 1. certifikatë e pronësisë
 2. leje qarkullimi
 3. certifikatë e kontrollit teknik
 4. siguracion i mjetit
- Faturë me Nr.R2379 dat 09.02.2015
- Deklaratë Doganore
- Foto të mjetit

- Kontratë Qeraje Nr.1975 Rep Nr.342/1 Kol datë 18.11.2019 lidhur ndërmjet shoqëria "Caushi" shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqëria "RSM Company" shpk në

cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënia me qera ndër të tjera të mjetit: Fadromë me targa AGMT 18, Leje qarkullimi BRF0258514 nr. Shasie CAT0442DKBRG00952.

- Kontratë Shitblerje Automjeti datë 14.12.2018 lidhur ndërmjet Tefik Peshtanaku në cilësinë e shitësit dhe shoqëria "Caushi M" shpk në cilësinë e blerësit me objekt MT me targa AGMT18 me nr.shasie CAT0442DKBRG00952.
- Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targë AGMT18 në emër të Tefik Peshtanaku, Leje qarkullimi, Policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik, foto.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*" *Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*"

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 "Kontratat për Punë Publike" pika 8 përcaktohet se: "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon*"

a licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantëtë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e kapaciteteve teknike ndër të tjera lidhur me mjetin: Fadromë copë 1.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "RSM Company" shpk, KPP konstaton se në përmbushje të këtij kriteri ankimesi ka paraqitur kontratë qeraje me subjektin "Caushi" shpk të lidhur para noterit. Bashkëngjitur kontratës së qerasë gjendet Kontratë Shitblerje Automjeti datë 14.12.2018 lidhur ndërmjet Tefik Peshtanaku në cilësinë e shitësit dhe shoqëria "Caushi" shpk në cilësinë e blerësit me objekt

MT me targa AGMT18 me nr.shasie CAT0442DKBRG00952. Gjithashtu bashkëngjitur kontratës gjendet edhe i gjithë dokumentacioni i mjetit: Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targë AGMT18 në emër të Tefik Peshtanaku, Leje qarkullimi, Policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik, foto, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në kontratë është deklaruar se mjetet e mësipërme nuk i janë dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër.

Gjithashtu konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur një deklaratë doganore për mjetin tip Fadromë me nr shasie EB98AF20217 me Faturë me Nr.R2379 dat 09.02.2015 në pronësi të tij, si dhe një deklaratë të plotësuar nga ana e administratorit të shoqërisë ku sqaron se në Republikën e Kosovës për Fadromat me goma nuk lëshohet: certifikatë e pronësisë; leje qarkullimi; certifikatë e kontrollit teknik; siguracion i mjetit.

KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues dëshmon se disponon me anë të kontratës së qerasë mjetin tip Fadromë me targa AGMT 18 e cila është e pajisur me dokumentacionin e kërkuar ligjor të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor se dokumentacioni i mjetit është në emër të një subjekti tjetër dhe jo shoqërisë "Caushi" shpk palës qeradhënëse në rastin konkret dhe skualifikimi i operatorit ekonomik "RSM Company" për këtë fakt nuk është i drejtë. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues ka provuar me dokumentacion konkret dhe bindës marrëdhënien që ekziston me subjektin që figuron në dokumentacionin e mjetit. Konkretisht është paraqitur kontrata e shitblerjes datë 14.12.2018 lidhur ndërmjet Tefik Peshtanaku në cilësinë e shitësit dhe shoqëria "Caushi M" shpk në cilësinë e blerësit me objekt MT me targa AGMT18 me nr.shasie CAT0442DKBRG00952 që provon se me akt noterial ka kaluar pronësia nga shitësi tek blerësi. Pra pavarësisht se dokumentacioni i mjetit figuron ende në emër të shitësit T.P dhe jo të palës blerëse shoqëria "Caushi" shpk, për shkak se nuk janë kryer ende veprimet administrative për ndërimin e emrit, nuk mundet që kontrata e qerasë lidhur mes "Caushi" shpk dhe "RSM Company" shpk e cila është lidhur rregullisht përpara noterit publik me Nr.1975 Rep Nr.342/1 Kol datë 18.11.2019 të mos merret në konideratë nga autoriteti kontraktor për efekt të përmbushjes së kriterit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se operatori ekonomik

ankimues "RSM Company" shpk provon me dokumentacionin e paraqitur se disponon në një nga mënyrat që parashikon ligji (me kontratë qeraje) mjetin tip Fadromë të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi me dokumentacionin përkatës.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky i vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion (kontrata e qerasë) është lidhur me shprehje të vullnetit të lirë të dy shoqërive nënshkruese të kontratës e për më tej, duke u dhënë të gjitha garancitë e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nga ana e shoqërisë qeradhënëse, pasi në këtë kontratë përmbahen të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gënjatur dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "RSM Company" shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se " *Sipas shtojcës 10 operatori ekonomik ka deklaruar se ka marrë me qera "Makinerinë pastrim me rërë kuarci me presion për heqjen e ndryshkut". Në kontratën e qirasë midis operatorit dhe subjektit "ESSA Industry" nuk është cituar afati i kontratës në kundërshtim me kriterin 2.3.10 ...për pajisjet teknike me qira, kontrata e qirasë duhet, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës... duke mos garantuar mbulimin me makineri për të gjithë periudhën e ekzekutimit të punimeve*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" pika 2.3.10 "Kapaciteti teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

2.3.10 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Fadroma	në pronësi ose me qira	Copë 1

2	Kamion 25 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamionçine 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Makineri Frezimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Rul hekure-hekur me kapacitet 5-12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Nivelues me goma (Rul)	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Furçe teli (metalike)	në pronësi ose me qira	Copë 5
12	Makineri pastrimi me rere kuarci me presion (garned 0.2-0.6mm) per pastrim ndryshku	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Saldatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Trapan	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Skele metalike 9deri 10m)	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Makineri vijezi	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga **DPSHTRR** (leje qarkullimi), certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/ çdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të përkohshëm), fotot dhe fatura tatimore përkatëse.

- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes /kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerave, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.

Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas përkatësisë. Kontratat e qerave duhet të përshkruhen të gjithë periudhën e realizimit të

kontrates dhe te deklarohet qartësisht nga qeradhensi qe mjeti nuk i eshte dhene me qera ndonjë subjekti tjetër per kete periudhe.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "RSM Company" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 10 "Mbi Disponimin e Makinerive"
- Kontratë Qeraje (pasuri e luajtshme) Nr.2005 Rep Nr.356/1 Kol datë 22.11.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria "Essa Industry" shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqëria RSM Company në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënia me qera e mjeteve të mëposhtme: Makineri pastrimi me rërë kuarci me presion (garned 0.2-0.6 mm) për pastrim ndryshku (sabiatrice) sipas Faturës me numër serie 75278825 të lëshuar më datë 21.11.2019. bashkëngjitur fatura.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës"

III.2.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantëtë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e kapaciteteve teknike ndër të tjera lidhur me mjetin: *Makineri pastrimi me rere kuarci me presion (garned 0.2-0.6mm) per pastrim ndryshku 1 copë.*

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “RSM Company” shpk, KPP konstaton se në përmbushje të këtij kriteri ankimesi ka paraqitur kontratë qeraje me subjektin “Essa Industry” shpk të lidhur para noterit shoqëruar me faturën tatimore të shitjes që vërteton pronësinë e mjetit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në kontratë është deklaruar se mjetet e mësipërme nuk i janë dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër.

KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes se *“Në kontratën e qirasë midis operatorit dhe subjektit “ESSA Industry” nuk është cituar afati i kontratës në kundërshtim me kriterin 2.3.10 ...për pajisjet teknike me qira, kontrata e qirasë duhet, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës... duke mos garantuar mbulimin me makineri për të gjithë periudhën e ekzekutimit të punimeve”*, KPP gjykon se duhet të mbajë në konsideratë parashikimet ligjore të përcaktuara në Kodin Civil ku parashikohet shprehimisht se:

Neni 659 “Përmbajtja e Kontratës”

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Neni 660

Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Neni 690

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Neni 803

Qiraja nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se 30 vjet, përvec kur parashikohet ndryshe nga ligji. Nëqoftë se ajo është e lidhur për një periudhë kohe më të gjatë ose pa afat ka fuqi vetëm për afatin e mësipërm.

Neni 821

Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit. Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.

III.2.9. Në interpretim literal të dispozitave të sipërcituara, KPP gjykon se kontratat janë veprime juridike të cilat lidhen me vullnet të lirë të palëve të cilët mund të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të lejuar me ligj. Kontratat lidhen duke respektuar disa kushte thelbësore të cilat janë shprehur qartësisht në ligj të tilla si pëlqimi i palës që merr përsipër një detyrim, të ketë një shkak të ligjshëm në të cilin mbështetet një detyrim, objekti i përcaktuar qartësisht si dhe aspekti formal që ka të bëjë me formën e kërkuar nga ligji. Pra mjafton që kontrata të përmbushë këto kondita të nevojshme për të qenë tërësisht e vlefshme dhe ligjore. Kontrata e lidhur ndërmjet palëve është një veprim juridik, e cila referuar Kodit Civil, është “shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

KPP gjykon se kontrata nuk përfundon vetëm në rastin e mbarimit të afatit të përcaktuar në të. Neni 690 parashikon se: Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj. Në interpretim literal të kësaj dispozite KPP gjykon se edhe nëse kontrata mund të ketë parashikuar një afat të caktuar ajo mund të priset në cdo kohë me pëlqim të palëve ose për shkak se njëra palë nuk përmbush detyrimet që rrjedhin prej saj e cila mund të detyrojë palën tjetër të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të saj. Pra në këtë kuptim

KPP gjykon se afati nuk është një garanci e dhënë njëherë e përgjithmonë që siguron autoritetin kontraktor se këto mjete do të jenë në dispozicion deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi. Për më tepër që referuar dispozitave të cituara më lart kontrata e qerasë mund të jetë edhe pa afat sikundër në rastin konkret. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me eksperiencat e mëparshme, makineritë e pajisjet, punonjësit dhe personelin e duhur, etj., duke paraqitur dokumentacion të vlefshëm në datën e hapjes së procedurës duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kriterëve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. Fakti që në kontratë nuk është përcaktuar afati i kontratës, nuk duhet të penalizojë subjektin duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t'u kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej në shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar shprehimisht se afati i kontratës është dt 22.11.2019-deri në përfundim të punimeve në objekt.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “RSM Company” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1/a (Për kapacitetin teknik – punët e ngjashme) pasi në dokumentacion e ngarkuar në sistem operatori dështon të tregojë që të ketë kryer punime riparimi ose rikonstruksioni, punime hekuri e betoni (sasitë e ekzekutuara në kontratat e ngjashme janë të papërfillshme) si dhe mungesë punimesh në vepra arti të vogla e mëdha*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

2.3.1/a Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

2.3.1/b.ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dy fishi i fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, Faturat, aktet e kolaudimit. Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.

2.3.1.b Në rastin e përvjes se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontrate e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, faturat, akt kolaudimi te objektit,

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "RSM Company" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Sipërmarrje Nr.prot 13419/7 datë 13.07.2016 me objekt Asfaltim i rrugës Shefqet Kuka lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe Shoqërisë Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hydro Company" degë e shoqërisë së huaj RSM Company me vlerë 61,728,293.45 lekë me tvsh. Procesverbal Kolaudimi, datë 20.06.2017, Procesverbal Marrje në Dorëzim të Objektit në përfundim të periudhës së garancisë së punimeve datë 23.07.2019, Formular Vlerësimi, Situacion përfundimtar (periudha nga fillimi deri Prill 2017, Faturë Tatimore Shitje Nr.831 dtaë 27.10.2016, Faturë Tatimore Shitje Nr.833 datë 02.12.2016, Faturë Tatimore Nr.03 datë 01.03.2017, Nr.07 datë 03.04.2017.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.24583/7 datë 02.11.2016 me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të lagjeve Maknor-Kolje-Ledhe" lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe BOE "Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company", degë e shoqërisë së huaj & "N.T.P Eurokos" degë e shoqërisë së huaj, me vlerë 60,974,865.71 lekë me tvsh. Akt marrëveshje për bashkimin e përkohshëm të shoqërive RSM Company shpk & "NTP Eurokos" ku rezulton se Kompania RSM Company ka marrë përsipër 70% të punimeve ndërsa kompania "NTP Eurokos" ka marrë përsipër 30% të punimeve. Shtojca e ndarjes së punimeve, Procesverbal kolaudimi datë 13.10.2017, Situacion Përfundimtar, Formular Vlerësimi, Procesverbal për marrje në shfrytëzim datë 12.04.2018, Faturë Tatimore Shitje Nr.09 datë 20.04.2017, Faturë Tatimore Shitje Nr.015 datë 04.08.2017, Faturë Tatimore Shitje Nr.022 datë 01.12.2017.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.prot 10156/7 datë 05.07.2017 me objekt "Sinjalistikë vertikale dhe horizontale për lidhjen e Unazës së Vogël me Unazën e Mesme të Tiranës", lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe shoqëria "Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company" degë e shoqërisë së huaj, me vlerë 19,979,602.8 lekë me tvsh, Procesverbal Kolaudimi datë 31.05.2018, Formular Vlerësimi, Situacion 1,2 dhe përfundimtar, Fatura Tatimore Shitje.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 6 përcaktohet se: *Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetëpunëve.

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6 Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik thekson se interpretimi i kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me natyrën e punimeve dhe elementëve konkretë të realizimit të tyre (zërat e preventivit) që autoriteti kontraktor synon të arrijë të kryjë në cilësinë e “investitorit”, pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar të suksesshëm.

III.3.7. Referuar arsyes së skualifikimit dhënë ankimuesit se kontratat e paraqitura nuk janë të ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se me dokumentacionin e paraqitur ankimuesi vërteton se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit, duke dëshmuar kapacitete për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë zëra të njëjtë punimesh pasi kjo vjen në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik si më sipër cituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencat të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar preventivit të punimeve të kontratave të realizuara nga operatori ekonomik ankimues të paraqitura në këtë procedurë si dëshmi e përvojës së tij të ngjashme të mëparshme, krahasuar me preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi, gjykon se ankimuesi ka realizuar zëra të ngjashëm me zërat e përcaktuar në kontratën objekt ankimi, duke dëshmuar kapacitetet e këtij operatori për të kryer punimet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ankimuesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RSM Company” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-40420-10-22-2019, me objekt “*Rikonstruksion i Ures së Vorës*”, me fond limit 18.794.948,46 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “RSM Company” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “RSM Company” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.18 Protokolli; Datë 08.01.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha